

VENDIM
Nr. 670, datë 7.8.2013

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE
MINISTRIA E DREJTËSISË, PËR DHOMËN KOMBËTARE TË AVOKATISË, TË PASURISË
SË PALUAJTSHME, ME SIPËRFAQE 25 000 M², ME NR. 1/190, NË ZONËN KADASTRALE
NR. 8210, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Drejtësisë, për Dhomën Kombëtare të Avokatisë, të pasurisë së paluajtshme, me sipërfaqe 25 000 (njëzet e pesë mijë) m², me nr. 1/190, në zonën kadastrale nr. 8210, Tiranë, për ta përdorur për ndërtimin e Shkollës Kombëtare të Avokatisë.

2. Prona e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar.

3. Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojnë ose t’ua japin në përdorim të tretëve.

4. Pasuria e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, është komponent i pronës nr. 64, me emërtim “Ish-fusha e aviacionit”, sipas hartës bashkëlidhur. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të bëjë saktësimin e të dhënave hartografike dhe të kufijve të pasurisë së paluajtshme, që i kalon në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Drejtësisë, për Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe më pas, menjëherë, të vijojë me procedurat e regjistrimit të ndryshimit të përgjegjësisë së administrimit në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

5. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Drejtësisë dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha